



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:051898  
Datë: 19.12.2018  
Numri i dokumentit: 00192087

**P.nr.614/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshem** - me Gjyqtaren Diana Sina, si dhe me procesmbajtësen Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Q. G. nga Gjakova, sipas Aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.488/2018 të datës 05.09.2018, për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhër ndëshkimor me datën **30.10.2017**, murr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP në Gjakovë, PP.nr.488/2018 e datës 05.09.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**I A K U Z U A R I:**

**Ç. G.**, nga i ati H. dhe e ëma I., e gjinisë B., data e lindjes ..., nga Gjakova, me banim në Rr."..." nr..., me nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

I.-Me datën 18.03.2018, rreth orës 04:10 minuta, në rrugën "S. Ll." në Gjakovë me të arritur në udhëkryq me rrugën "...", duke drejtuar automjetin e tipit ..., me targa regjistrimi . . . duke mos respektuar rregullat e komunikacionit rrugorë, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e të dëmtuarve A. L. G. M. ashtu që ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin, 48, 49, 53, 54, 60, dhe nenin 61 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugorë edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vie deri tek pasoja, lehtas e ka marrë se gjer tek ajo nuk do të vjen apo në momentin e duhur do ti shmanget, në atë mënyrë me të arritur në udhëkryq në rrugën ". . ." rrugë me përparësi kalimi duke mos pasur kujdes të shtuar në shpejtësinë e lëvizjes, kushteve, rrethanave të rrugës po

ashtu në shenjën e trafikut "STOP", rrugë me përparësi kalimi ku papritmas pa u siguru mirë kyçet në udhëkryq krejtësisht në mënyrë të pasigurt duke ia marrë përparësinë e kalimit ngasësit të automjetit . . . , me targa . . . me ngasës G. M. i cili në momentin kritik ishte në lëvizje përgjatë rrugës ". . ." rrugë me përparësi kalimi. Si pasojë e kësaj në pamundësi që ti shmanget aksidentit me pjesën e parme ballore të anës së djathtë të automjetit . . . , godet në pjesën e parme të anës së majtë automjetin . . . , si pasojë e goditjes mes automjeteve, automjeti . . . , e humb kontrollin mbi automjetin e tij dhe me pjesën e parme ballore e godet lokalin me pronar F. B. ndërsa automjeti . . . nga inercioni i goditjes sjellët në rrugë, nga pasojat e aksidentit shkaktohen dëme materiale në të dyja automjetet e aksidentuara dhe dëme materiale shkaktohen në pronën private gjegjësisht në lokalin frizer ". . .", ndërsa lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit për të dëmtuarit e lartcekur, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. F. D. të dt. 16.08.2018

- me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

**II**-Me datë, kohë, vend dhe mënyre të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze i akuzuari humb kontrollin mbi automjetin dhe me pjesën e parme ballore, e godet lokalin e të dëmtuarit F. B. që gjendej skaj rrugës me çka i ka shkaktuar kështu të njëjtit dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata komfor nenit 4, 41, 43, 46, nenit 378 par.6 lidhur me par.1 dhe nenit 333 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 495 të KPPK-së, të akuzuarit:

## I SHQIPTON

-Për veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën I-rë të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me gjobë në shumën prej **350.-(Treqind e pesëdhjetë).-€**,

-Për veprën penale, asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën II-të të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me gjobë në shumën prej **250.-(Dyqindpesëdhjetë).-€**,

-Për dy vepra penale, për të cilat është shpallur fajtor, në kuptim të nenit 80 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, i shqipton **dënim unik** me gjobë në shumë prej **600.-(gjashtëqindë) Euro**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë.

Nëse përsone i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30 (tridhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00€, (njëzet) euro** të gjobës.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër të ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej **40.88 €**, dhe në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor të paguaj shumën prej **50,00 €**, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00 €**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Të dëmtuarit: A. L. nga Gjakova, F. B. B. nga Gjakova në rr. . . , nr.12, G. I. M. nga Gjakova në rr. . . ” nr.18 kompensimin e dëmit mund ta realizojë në kontest civil.

### **Arsyetim**

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.488/2018 të datës 05.09.2018, kundër të akuzuarit Ç. G. nga Gjakova, për shkak të veprave penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, me propozim që ndaj të akuzuarit ti epet urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-së gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-së dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe ti shqiptoi ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së-së e cila dispozitë për kryesin e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, dhe dispozitës së neni 333 par.1 të KPRK. e cila dispozitë për kryesin e kësaj veprë penale parasheh dënim me burgim deri në një (1) vit.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Deklarata e të pandehurit Ç. G. dhënë në polici me dt.19.03.2018,
  - Deklarata e të dëmtuarit G. M. dhënë në polici me dt. 19.03.20148,
  - Deklarata e dëshmitarit F. B. dhënë në polici me dt.19.03.2018,
  - Raporti i hetuesit L. K. # 3026 mbi vend shiqimin e aksidentit,
  - Raportet mjekësore të Spitalit Rajonal “. . . ” në Gjakovë me nr. . . . . , . . . të dt.18.03.2018,
  - Konstatimi dhe mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F. D. të dt.16.08.2018,
  - Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ingj. A. H. të dt.05.09.2018.
- dhe shkresat tjera në lëndë janë provat të mjaftueshme me të cilën argumentohet se i akuzuari është kryes i veprës penale për të cilën pandehet.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragraf 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
-Departamenti i Përgjithshëm-  
P.nr.614/2018, më datën 30.10.2018.**

**Procesmbajtësja  
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja,  
Diana Sina**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarit të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merre formë të prerë.

Numri i lëndës: 2018:051898  
Datë: 19.12.2018  
Numri i dokumentit: 00192087